

Satuti i Federatës së Karatesë të Kosovës

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



STATUTI I
FEDERATËS SË KARATESË TË KOSOVËS

PRISHTINË 2021

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-043 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 të datës 16.03.2015 për regjistrim dhe licencim të Federatave dhe Shoqërive Sportive dhe Nenit 32 të Ligjit Nr 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/24 për Sport (Gazeta Zyrtare Nr. 02/2012 me datë 20.01.2012), dhe Ligji Nr. 05/L-075, ky Statut do të qeverisë organizatën joprotabile "Federata e Karatesë e Kosovës" me seli në Prishtinë.

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Emri, shenja dhe adresa

1. Organizata do të quhet "Federata e Karatesë e Kosovës" – "Kosova Karate Federation".
 2. Organizata mund të njihet edhe me shkurtesën: "FKK" dhe "KKF".
 3. Federata kryen aktivitetet e veta në përputhje me parimet e Kartës Olimprike, ligjit dhe statutit të vet.
 4. Federata e Karatesë e Kosovës (më tej Federata), me seli në Prishtinë, është organizatë joprotabile, jopolitike dhe jokonfesionale.
 5. Federata nuk do të bëjë shpërndajne e çfarëdo fitimi neto apo të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i Federatës do të shfrytëzohen për të mbështetur qëllimet joprotabile te saj dhe nuk do të shfrytëzohen për përfitime të veçanta individuale në mënyrë direkte apo indirekte, për asnjërin nga themeluesit, kryetarin, nënpunësit apo ndonjërin anëtar të Bordit të vet, të punësuar apo donator të Federatës.
 6. Megjithatë, pagesa e kompensimit të arsyshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për Federatën.
 7. Çfarëdo transaksioni në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit të Federatës, personi apo nënpunësi të Federatës do të mbyllet me vlera reale të tregut, apo në kushte që janë më të favorshme për Federatën.
 8. Selia e Federatës është në Prishtinë, në Shtëpin e Sporteve, Rr. Agim Ramadani nr. 22 kati 2-të. Sporti i karatesë është institucionalizuar në vitin 1974. Në vitin 1980 është themeluar Lidhja e Karatesë së Kosovës, që në vitin 1992 është transformuar në Federatën e Karatesë të Kosovës. Federata ka vulat e saj në formë të rrethit dhe katrore në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe në anglisht. Vula në formë të rrethit ka diametër prej 35 mm, kurse vula katrore është e gjerë 15 mm.
-

Vula në formë rrethi ka të shkruar tekstin si në vijim: "Federata e Karatesë e Kosovës" në gjuhën shqipe. Teksti i njëjtë është i shkruar edhe serbisht dhe anglisht, por me shkronja të madhësisë më të vogël. Në mes të vulës është harta e Kosovës me grushtin në mes të hartës, kurse mbi grusht janë gjashtë yje.

9. Vetëm FKK mund të ketë vula për shërbime të FKK-së, sikurse është përshkruar në pikën 1.8 të këtijë neni. Komisionet dhe trupat tjera përbërse të FKK-së nuk mund të kenë vula vetanake.

9.1 Federata ka logon dhe flamurin e saj. Vendimi për logo dhe flamur është marrë nga Kuvendi i FKK-së në vitin e aprovimit të këtij statuti.

10. Federata e Karatesë e Kosovës ka llogarinë e vet rrjedhëse bankare.

II. QËLLIMI

Neni 2 Qëllimi i Federatës

a. Qëllimi i Federatës është me sa vijon:

1. Të zhvillojë, të forcojë dhe të avancojë sportin e karatesë në Kosovë.
2. Federata është anëtare me të drejta të plota në Federatën Botërore të Karatesë (WKF) dhe Federatën Evropiane të Karatesë (EKF). Federata njih të gjitha dokumentet, vendimet, sistemin dhe rregullat e garave të Federatave të lartpërmendura dhe organizatave të pranuar nga WKF/EKF.
3. Federata do të respektoj të gjitha vendimet e Komitetit Olimpik të Kosovës.
4. Federata njih dhe respekton të gjitha vendimet e Agjencisë për Antidoping të Kosovës si dhe Kodin Botëror për Antidoping dhe duhet të nxjerr dhe aprovoj Rregullore përkatëse për Anti-Doping.
5. Federata ka për qëllim që të promovojë, organizojë, rregullojë dhe popullarizojë sportin e karatesë në gjithë Kosovën; të mbrojë shëndetin fizik dhe mental të atletëve, të kontribuojë në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore me federatat dhe organizatat sportive dhe të mbrojë interes e karatesë së Kosovës.
6. Ngritja e cilësisë së karatesë në të gjitha nivelet.
7. Të zhvillojë dhe përparojë karatenë në mesin e të rinjve, posaçërisht në mesin e fëmijve.

b. Për të përmbushur këto qëllime, Federata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

1. Të organizojë gara të ndryshme në sportin e karatesë në të gjitha nivelet, kategoritë dhe grupmoshat; kampionate zyrtare, gara miqësore, turne dhe turne memoriale në Kosovë.
2. Të organizojë seminare dhe gara për të rritur, për student dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në aktivitetet e karatesë; të organizojë provime për breza për mosha të ndryshme të karatesë dhe provime për tituj të gjyqtarëve të karatesë.
3. Të organizojë stërvitje dhe aktivitete të përbashkëta të kampeve të karatesë, duke përfshirë stërvitje të vazhdueshme të individëve në fushën e karatesë.
4. Të vë bashkëpunim të afërt me asociacionet e karatesë, fondacionet, federatat dhe organizatat e ngjashme brënda dhe jashtë Kosovës.
5. Të bashkëpunojë me klubet e karatesë, shkollat dhe universitetet, asociacionet, ndërmarrjet, Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe qytetarët e Kosovës, si dhe institucionet tjera në Kosovë, përfshirë edhe entitetet tjera dhe në veçanti të bashkëpunojë me Departamentin e Sportit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës dhe me Komitetin Olimpik të Kosovës.

III. ANËTARËSIMI

Neni 3

1. Anëtarësimi në Federatë është i bazuar në mundësi të barabarta për të gjitha klubet në territorin e Kosovës, të cilat janë të regjistruara në bazë të legjislacionit ekzistues për sport në Kosovë, por edhe në bazë të rregulloreve përkatëse dhe statutit të Federatës së Karatesë së Kosovës.
 2. Klubet anëtare të Federatës duhet të paguajnë anëtarësinë vjetore, lartësinë e së cilës e përcakton Bordi i Federatës. Mospagesa e anëtarësisë vjetore, edhe pas vërejtjes me shkrim, do të rezultojë me përjashtim të klubit anëtar nga Federata.
 3. Anëtarësia gjithashtu mund të ndërpritet apo të pezullohet me vendim të Kuvendit të Federatës nëse një anëtarësim i tillë do të dëmtonte moralisht dhe materialisht organizatën dhe nëse anëtarësimi i tillë është në kundërshtim me këtë Statut.
 4. Në rast të pezullimit, kohëzgjatja e këtij pezullimi do të përcaktohet nga ana e Bordit deri në mbajtjen e mbledhjes së radhës së Kuvendit. Ndërprerja apo pezullimit i anëtarësisë nga ana e Kuvendit do të aprovet me shumicë votash të anëtarëve prezentë në mbledhje të Kuvendit.
 5. Klubi i posa themeluar, për të marrë statusin e anëtarit me të drejta të plota (përfaqësim dhe të drejtë të votës në kuvend), pas kërkesës me shkrim, duhet që në atë vit kalendarik të marrë pjesë të paktën në tri gara zyrtare sipas kalendarit të FKK-së.
-

IV. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve

Neni 4

1. Klubet anëtare kanë të drejtë pjesëmarrjeje në mbledhjet e Kuvendit në bazë të rregulloreve dhe normave statutare të caktuara me këtë Statut.
2. Klubet anëtare marrin pjesë në gara zyrtare të organizuara nga Federata, në pajtim me rregulloret e garave të organizatave të cekura sipas nenit 2, pika 2 e këtijë statuti.
3. Nëse brënda një viti, një klub nuk ka marrë pjesë së paku në tri (3) gara zyrtare të Kosovës, atëherë ai klub humb të drejtën e votës në Kuvendin e Federatës në vitin vijues.
4. Pas pezullimit, klubet e karatesë janë të obliguara që të ripërtërijnë kërkesën për anëtarësim sipas rregulloreve përkatëse për regjistrim në FKK.
5. Vendimi për përjashtim të një klubi anëtarë i federatës mund të merret vetëm atëherë kur në mbledhje të kuvendit janë së paku 2/3 e anëtarëve të Federatës të pranishëm në mbledhje. Klubet anëtare mund të përjashtohen nga Federata me një vendim të miratuar nga Kuvendi me 2/3 e votave të anëtarëve të Kuvendit prezentë në mbledhje.
6. Klubet anëtare të FKK-së dhe të gjithë anëtarët e rregullt të FKK-së e gëzojnë të drejtën e anëkeses në këshillin e Arbitërazhit Sportiv në kuadër të KOK-ut, pasi të jenë shterrur të gjitha të drejtat tjera të ankimimit në FKK.

V. ORGANET QEVERISËSE TË FEDERATËS

KUVENDI I FEDERATËS

Neni 5

1. Organet qeverisëse të Federatës janë Kuvendi, Bordi, dhe Këshilli Mbikëqyrës të cilat zgjedhen nga Kuvendi.
 2. Kuvendi i Federatës është organi më i lartë qeverisës i Federatës. Është i përbërë nga një përfaqësues prej çdo klubi anëtar.
-

3. Kuvendi i Federatës është përgjegjës për politikën e përgjithshme dhe çështjet financiare.
4. Përpos autorizimeve që i ka Kuvendi në bazë të Statutit, ai gjithashtu është përgjegjës edhe për të caktuar numrin e zyrtarëve, për të vendosur për emërimin apo revokimin e anëtarëve të Bordit, për miratimin e raporteve të zyrtarëve, për miratimin e vendimeve të caktuara për çështje pronësore për vlera të caktuara, për vendosjen rreth çështjeve ligjore dhe pronësore, për të rishikuar ankesat dhe parashtrirat, për ndryshimet e statutit dhe për të vendosur lidhur me anëtarësimin apo përjashtimin e anëtarëve të Federatës.
5. Kuvendi i Federatës mund t'ia bartë disa nga kompetencat e veta Bordit të Federatës, apo ndonjëherë nga organet zyrtare të organizatës në bazë të vendimit të shumicës së anëtarëve, përderisa një transfer i tillë është i paraparë me Rregulloren të Bordit, të cilin e aprovon Kuvendi.

VI. Mbledhjet e Kuvendit

Neni 6

1. Kuvendi i rregullt zgjedhor i FKK-së mbahet në vitin e Olimpiadës verore, e më se voni deri me 10 mars të vitit vijues.
 2. Kuvendi do të konvokohet së paku një herë në vit për Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV), ku do të bëhet vlerësimi dhe aprovimi i fondit, obligimeve, shpenzimeve dhe të hyrave, përfshirë programet për periudhën e ardhshme. Me 2/3 e anëtarëve të klubeve të anëtarësuara në Federatë, do të aprovohet një kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme.
 3. Anëtarët e Kuvendit mund të takohen edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga 2/3 e klubeve anëtare të Kuvendit, apo Bordit të Federatës. Një kërkesë e tillë duhet që të regjistrohet në librin e protokollit dhe t'i paraqitet administratorit të Federatës. Me të pranuar kërkesën, administratori do të informojë Bordin e Federatës, i cili është i obliguar që të rishikojë kërkesën dhe të caktojë mbledhjen jo më vonë se 30 ditë pas ditës së marrjes së kërkesës.
 4. Në rast se Bordi i Federatës nuk vepron me kohë, nënshkruarit kanë të drejtë që të themelojnë një Këshill prej tre anëtarësh dhe të thërrasin MPJ-në dhe të zgjedhin organet e reja të Federatës sikurse parashihet me këtë Statut.
-

5. Ftesa për MPV si dhe për MPJ do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, duke theksuar datën, kohën dhe vendin e takimit që do të mbahet, së bashku me rendin e ditës, së paku 10 ditë para datës së mbajtjes së takimit.
6. Për të mbajtur mbledhjet, është e nevojshme që të jenë prezentë më tepër se gjysma e anëtarëve të Kuvendit (50% + 1). Nëse kjo nuk është e mundur, nëse nuk ka kuorum, mbledhja do të shtyhet për një ditë tjetër, për të cilën anëtarët do të lajmërohen me kohë.
7. Çdo anëtar i Federatës ka të drejtën e një vote në Kuvend.
8. Vendimet në Kuvend merren me shumicë të anëtarëve të Kuvendit përveç nëse është e paraprë ndryshe me këtë statut.
9. Anëtarët e Kuvendit duhet të respektojnë dhe veprojnë sipas Rregullorës për Konflikt të Interesit.

VII. BORDI I FEDERATËS

Neni 7

1. Përveç kompetencave të përshkruara me këtë Statut, Bordi është përgjegjës për kontrollim, mbikëqyrje dhe menaxhim të çështjeve administrative, organizative, dhe financiare si dhe të pronës së Federatës. Bordi i Federatës duhet gjithmonë të veprojë sipas objektivave të Federatës.
 2. Bordi Ekzekutiv i Federatës së Karatesë do të jetë përgjegjës për eliminimin e konfliktit të interesit.
 3. Bordi i Federatës do të ketë edhe këto kompetenca shtesë:
 - a) Të menaxhojë asetet dhe pronën në mënyrë të arsyeshme;
 - b) Të zbatojë konkluzionet dhe vendimet e Kuvendit;
 - c) Të organizojë mbledhjet e Kuvendit;
 - d) Të propozojë anëtarë të rinj për pranim në Federatë;
 - e) Të organizojë të gjitha aktivitetet e Federatës;
 - f) Të propozojë Statutin, amandamentimet e Statutit dhe të rregulloreve të tjera të Federatës;
 - g) Të përfaqësoj dhe të veprojë në emër të Federatës;
 - h) Të caktojë dhe të emërojë përfaqësues të Federatës dhe të vendosë për kompetencat e tyre sipas rregulloreve të miratuara;
-

4. Bordi aprovon kalendarin vjetor të garave, vendos për pjesëmarrje të ekipit kombëtarë në gara ndërkombëtare; aprovon pjesëmarrjen e zyrtarëve të Federatës në gara, në të cilat nuk merr pjesë ekipi kombëtar.
 5. Bordi i Federatës përbëhet nga anëtarët e Federatës. Anëtarët do të zgjidhen individualisht nga ana e Kuvendit me shumicë votash. Secili anëtar i Bordit të Federatës do të ketë mandate katërvjeçar.
 6. Bordi i Federatës do të ketë **15 anëtarë**: kryetarin, dy nënkryetarë dhe trembëdhjetë (13) anëtarë. Të dy gjinitë, mashkullore dhe femërore, si dhe minoritetet do të kenë mundësi të barabarta të përfaqësimit sipas Ligjit për Sport.
 7. Përfaqësimi gjinorë duhet të jetë në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, me përfaqësim minimal prej 30% dhe në përputhje me Rregulloren e Bordit të FKK-së.
 8. Anëtarët e Bordit mund të zgjidhen për mandate të njëpasnjëshme.
 9. Anëtarët e Bordit mund të revokohen, individualisht dhe/apo më shumë se një anëtarë para përfundimit të mandatit të tyre me shumicë votash në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore dhe/apo Mbledhjen e Jashtëzakonshme Vjetore të Kuvendit.
 10. Në rast të vdekjes, dorëheqjes apo revokimit të kryetarit të Federatës së Karatesë së Kosovës, ai/ajo do të zëvendësohet nga njëri nga nënkryetarët, apo cilido anëtar i Bordit, apo ndonjëri nga anëtarët deri në mbledhjen e rregullit të Kuvendit me vendim të Bordit. Edhe kjo është e përcaktuar me Rregullore të punës së Bordit, të cilën e aprovon Kuvendi i radhës.
 11. Vendimet e Bordit Ekzekutiv merren me shumicë votash (50% + 1).
 12. Bordi i Federatës mund t'ia adresojë çfarëdo çështjeje Kuvendit për konsiderim dhe vendim.
 13. Anëtarët e Bordit të Federatës nuk mund të kompensohen me çfarëdo shume pa vendim paraprak të Kuvendit, ndërsa një kompensim apo pagesë mund të bëhet vetëm në rastin kur kjo është e arsyetuar dhe është kryer për interes të Federatës.
 14. Secili anëtar i Bordit gjatë votimit për çfarëdo vendimi apo çështje tjetër, gjatë votimit duhet të respektojë Rregulloren e Konfliktit të Interesit.
-

VIII. KRYETARI

Neni 8

1. Kryetarin e zgjedh Kuvendi me mandat katërvjeçar me shumicë votash, jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.
 2. Kryetari emëron edhe 3 anëtarë të Bordit të FKK-së për të plotësuar numrin e përgjithshëm prej 15 anëtarëve.
 3. Kryetari përfaqëson Federatën e Karatesë së Kosovës.
 4. Kryetari komunikon me institucionet mbikëqyrëse shtetërore, me Departamentin e Sportit të MKRS të Republikës së Kosovës, me Komitetin Olimpik të Kosovës, me asociacionet ndërkombëtare sportive të karatesë dhe me WKF dhe EKF.
 5. Kryetari thërret dhe udhëheq Kuvendin si dhe Bordin e Federatës.
 6. Kryetari thërret dhe udhëheq Bordin pasi të jetë aprovuar rendi i ditës dhe në të njëjtën kohë ai monitoron implementimin e vendimeve të miratuara.
 7. Vendimet e marra nga Kryetari i FKK-së sipas pikes 8.6 të nenit 8 janë të plotfuqishme deri në takimin e radhës së Bordit të FKK-së për vendim.
 8. Gjatë situatave emergjente, të gjitha vendimet të marra nga Kryetari duhet të propozohen për ratifikim në takimin e radhës të Bordit.
 9. Në rast se Kryetari mungon apo është në dorëheqje, të gjitha autorizimet i merr nënkryetari i parë apo i dytë, varësisht se si është përcaktuar kjo çështje me Rregulloren e Punës së Bordit.
 10. Kryetari nënshkruan akte normative dhe dokumente të tjera të cilat i aprovon Kuvendi dhe Bordi Ekzekutiv i FKK-së.
 11. Kryetari kujdeset për ligjshmërinë e punës së Federatës së Karatesë së Kosovës.
 12. Ai aplikon dhe menaxhon të gjitha politikat e Federatës së Karatesë së Kosovës.
-

13. Kryetari kërkon zbatimin e planit financiar, nënshkruan dokumentacionin financiar, përfshirë edhe aprovimin dhe përcjelljen e transaksioneve financiare.
14. Kryetari raporton para Kuvendit të Federatës së Karatesë së Kosovës.
15. Në rast të dorëheqjes, suspendimit, përjashtimit apo vdekjes së një anëtari të Bordit të FKK-së, Kryetari mund të emrojë një anëtarë tjetër në Bord deri në mbeldhjen e radhës së kuvendit të punës apo atij zgjedhor, sipas diskrecionit të tijë, nga lista e më të votuarëve në zgjedhjet e fundit.

IX. NËNKRYTARËT

Neni 9

1. Nënkyetarët janë të zgjedhur nga Kuvendi përmes votimit të fshehtë me shumicë votash me mandate katërvjeçare.
2. Nënkyetari i parë dhe i dytë përcaktohet sipas votave të fituara në Kuvend.
3. Nënkyetarët i asistojnë Kryetarit dhe zëvendësojnë atë në rast nevoje sipas procedurës së përcaktuar me Statut apo me Rregulloren e Punës së Bordit.

X. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 10

1. Sekretarin e Përgjithshëm e emëron Bordi me propozim të kryetarit për mandat katërvjeçar me mundësi të rizgjedhjes.
 2. Sekretari i FKK-ës është person i afirmuar sportiv në sportin e karatesë, njohës i organizatës së Federatës në të gjitha segmentet e punës.
 3. Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm janë si vijon:
 - a) Ndërmerr veprime të nevojshme për zbatim të vendimeve të Federatës së Karatesë së Kosovës.
 - b) Kujdeset për zbatimin e Statutit, Rregulloreve, vendimeve të Bordit dhe të programit të aktiviteteve të Federatës.
 - c) Është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e zyrës dhe menaxhimit të stafit administrativ të zyrës.
 - d) Sekretari duhet të jetë njohës i mirë i njërës nga tri gjuhët zyrtare të WKF-së.
-

4. Me autorizim të Kryetarit, sekretari kryen detyra tjera të caktuara/ndara nga Kryetari dhe Bordi, siç janë:
 - a) Bashkërendon dhe ndihmon në punën e komisioneve të ndryshme në mes të zyrës së Federatës dhe komisioneve;
 - b) Kujdeset për zbatimin e bashkëpunimit në mes të WKF dhe federatave e organizatave jashtë Kosovës;
 - c) Kujdeset për bashkëpunimin në mes të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe FKK-së;
 - d) Kordinon bashkëpunimin me departamentin e Sportit dhe organizatat tjera sportive në Kosovë;
 - e) Bënë përgaditjet për Kuvend të Përgjithshëm dhe për mbledhjet e Bordit Ekzekutiv të-FKK-së;
 - f) Me rol këshillues merr pjesë rregullisht në Kuvendin e Përgjithshëm dhe mbledhjet e Bordit Ekzekutiv
 - g) Bashkëvepron me zëdhënësin në kryerje të punëve ndërlidhëse me medie;
 - h) Jep propozime për Bordit lidhur me profilin e të anagazhuarave bashkëpunëtorëve profesionalë dhe administrativ të zyrës së FKK-së;
 - i) Kryerja e detyrave të tjera të përshkruara në aktet normative të Federatës;
5. Sekretari i Përgjithshëm për punën e vet i përgjigjet Bordit të Federatës.
6. Sekretari i Përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit nëse dështon në kryerjen e detyrave të besuara.
7. Për punën në Federatë, Sekretari do të marr kompensim ose pagë, e cila do të rregullohet me vendimin për punësimin ose kontratë.
8. Përgjegjës për ligjshmërinë në punën e FKK-së.

XI. KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 11

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga pesë (5) anëtarë të zgjedhur nga ana e Kuvendit me shumicë votash për një mandate katërvjeçar. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë në pozita ekzekutive të FKK-së.
-

2. Kryesuesi i Këshillit Mbikëqyrës zgjidhet në bazë të Rregullores së punës së Këshillit Mbikëqyrës.
3. Këshilli Mbikëqyrës kryen detyrat e veta në bazë të Rregullores dhe për punën e vet i raporton Kuvendit.
4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

XII. KOMISIONET E PËRHERSHME

Neni 12

1. Për të përmbushur programin e punës, Federata themelon komisione, përmes të cilave realizon qëllimin, objektivat dhe plan-programin e vet.
 2. Komisionet do të jenë trupa operative të Federatës të cilat do të themelohen sipas këtijë statuti dhe do të udhëhiqen nga rregulloret e veta.
 3. Federata mund të shtojë apo të zvogëlojë numrin e komisioneve varësisht prej nevojave dhe kërkesave të punës. Komisionet aktuale janë si në vijim:
 - a) Komisioni për Çështje Juridike,
 - b) Komisioni i Garave,
 - c) Komisioni i Gjyqtarëve,
 - d) Komisioni Mjekësor dhe Antidoping,
 - e) Komisioni i Gradave,
 - f) Komisioni Disiplinor,
 - g) Komisioni për Shpërblime dhe Mirënjohje,
 - h) Komisioni për Zgjedhjen e Sportistit të Vitit.
 - i) Komisioni për Media dhe Marrëdhënie me Publikun,
 - j) Komisioni për Para-Karate,
 - k) Komisioni për Trajner dhe zhvillim profesional
 4. Bordi Ekzekutiv i FKK-së zgjedhë kryesuesit e Komisioneve përkatës sipas kriterëve të përcaktuara me konkurs (siç janë përcaktuara në rregulloret përkatëse), ndërsa anëtarët tjerë të komisioneve zgjedhen nga kryesuesi i komisionit sipas kriterëve të parapara në rregulloret përkatëse.
 5. Në rast se Bordi Ekzekutiv i FKK-së konstaton se gjatë përzgjedhjes së anëtarit/anëtarëve të komisioneve nuk janë respektuar kriteret e përzgjedhjes sipas rregulloreve përkatëse, Bordi do të kërkojë që kryesusi menjëher të ndërmerë masa korrektuese të vendimit.
-

6. Kryesurit e komisioneve për punën e tyre i raportojnë Bordit Ekzekutiv të FKK-së dhe/apo Kryetarit të FKK-së sipas rregulloreve të komisioneve të përkatëse dhe kurdo herë që një gjë e tillë u kërkohet.
7. Kryesusi i një komisioni mund të shkarkohet nga Bordi Ekzekutiv për dështim të realizimi të përmbushjes së obligimeve dhe objektivave të përckatuara me rregullore, për shkelje të rregullores përkatëse dhe shkelje tjera disiplinore që dëmtojnë prestigjin e karatesë.
8. Rregulloret e përpiluara nga komisionet do të dërgohen në Komisionin për Çështje Juridike për aprovim. Rregulloret e aprovuara nga Komisioni për Çështje Juridike do të dërgohen në Bordin e FKK-së për miratim.
9. Anëtarët e Bordit të FKK-së nuk mund të jenë edhe anëtarë as kryesues të Komisioneve të FKK-së.
10. Bordi zgjedh përzgjedhësin/it e përfaqësueses së FKK-së nëpërmjet konkursit duke u bazuar në rregulloren përkatëse dhe miraton listen e trajnerëve të propozuar nga përzgjedhësi/it.
11. Trajnerët e përfaqësueses do të caktohen nga përzgjedhësi sipas rregullores për përzgjedhje të trajnerëve.
12. Në rast se Bordi Ekzekutiv i FKK-së konstaton se gjatë përzgjedhjes së trajnerëve së përfaqësueses nuk janë respektuar kriteret e përzgjedhjes sipas rregullores përkatëse, i njëjti do të kerkoje nga përzgjedhësi/t menjëher të ndërmarrin masa korrektuese të vendimit.
13. Përzgjedhësi/t e përfaqësueses për punën e tyre i raportojnë Bordit Ekzekutiv dhe/apo kryetarit të FKK-së sipas rregullores përkatëse.
14. Përzgjedhësi/t e përfaqësueses mund të shkarkohet/n nga Bordi Ekzekutiv për dështim të realizimi të përmbushjes së obligimeve dhe objektivave të përckatuara me rregullore, për shkelje të rregullores përkatëse dhe shkelje tjera disiplinore që dëmtojnë prestigjin e karatesë.

XIII. RREGULLORET E FKK-SË

Neni 13

1. Federata e Karatesë e Kosovës për realizimin e qëllimit të vet dhe përmbushjes së objektivave zbaton rregulloret në vijim:
 - a) Rregullore e Punës së Kuvendit të FKK-së
 - b) Rregullore e Punës së Bordit të FKK-së
-

- c) Rregullore e Punës së Këshillit Mbikëqyrës
- d) Rregullore për Organizim të Brendshëm të FKK-së
- e) Rregullore e Kodit të Etikës
- f) Rregullore për Çëshjte Juridike
- g) Rregullore e Garave
- h) Rregullore e Gjyqtarëve
- i) Rregullore për Trajner dhe zhvillimi profesional
- j) Rregullore për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
- k) Rregullore e Komisionit Disiplinor
- l) Rregullore për Mjekësi
- m) Rregullore për Anti-Doping
- n) Rregullore për Para-karate
- o) Rregullore për Përzgjedhje të Selektorit
- p) Rregullore për Selektor dhe Trajner të Përfaqësueses
- q) Rregullore për Punë të Ekipit të Përfaqësueses
- r) Rregullore për Mëditje dhe Shpërblime
- s) Rregullore për Zgjedhje të Sportistit të Vitit
- t) Rregullore për Grada
- u) Rregullore për Siguri dhe Shëndet në Gara
- v) Rregullore për Shmangie nga Konflikti i Interesit
- w) Rregullore për Regjistrim të klubeve dhe garuesve.

XIV. GRADAT

Neni 14

1. Çështja e gradave në Federatë rregullohet me Rregulloren e Gradave të Federatës së Karatesë të Kosovës.

XV. EKIPI KOMBËTAR DHE TRANSFERIMI I GARUESEVE

Neni 15

1. Federata e Karatesë e Kosovës në garat ndërkombëtare përfaqësohet nga garuesit kosovarë sipas mënyrës së paraparë me Rregulloren e Përfaqësueses së Kosovës në karate.
 2. Transferimi i garueseve nga një klub në tjetrin brenda Federatës kryhet sipas dispozitave të Rregullores për Regjistrim dhe Transfer të Garuesve.
-

XVI. SHËRBIMI ADMINISTRATIV I FEDERATËS

Neni 16

1. Në rast nevoje, Bordi do të angazhojë persona, të cilët do të kryejnë detyra ditore të Federatës. Kohëzgjatja e angazhimit të tyre do të caktohet nga Komisionet gjegjëse sipas rregulloreve të tyre.
2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes një kontrate (me përshkrim të detyrave për secilin), e cila përshkruan në detaje pagesat e tyre dhe përfitimet tjera.
3. Shpërblimet dhe Mirënjohjet do të kryhen sipas Rregullores për Shpërblime dhe Mirënjohje.

XVII. INFORMIMI I ANËTARËVE TË FEDERATËS

Neni 17

1. Aktivitetet e Federatës janë publike dhe informimi i antëtarëve të vetë dhe publikut për punën e vetë do të bëhet sipas Rregullores për Media dhe Marrëdhënie me Publik.
2. Federata dë të bëjë të gjitha njoftimet dhe publikimet sipas Rregullores për Media dhe Marrëdhënie me Publik.
3. Federata do të ketë zëdhënsin e vet i cili do të jetë pjesë e Komisionit për Media dhe Marrëdhënie me Publik.

XVIII. SHPËRBLIMET DHE MIRËNJOHJE

Neni 18

1. Për rezultate të jashtëzakonshme në fushën e avancimit dhe zhvillimit të sportit, Federata, në bazë të vendimit të marrë nga Bordi Ekzekutiv, mund të ndajë diploma, certifikata dhe mirënjohje për organizatat dhe individët e merituar, për të cilat perkujdeset komisioni përkatës.
 2. Shpërblimet dhe Mirënjohjet do të ndahen sipas Rregullores për Shpërblime dhe Mirënjohje.
-

XIX. KRYETARI I NDERIT DHE ANËTARËT E NDERIT

Neni 19

1. Në bazë të propozimit të Komisionit përkatës, Kuvendi i Federatës mund të zgjedh me aklamacion Kryetarin e nderit dhe Anëtarët e nderit.
2. Ata do të zgjidhen nga anëtarët, të cilët kanë dhënë kontribut të pakontestueshëm në afirmimin dhe avancimin e karatesë dhe kanë janë shpërblyer me mirënjohje të veçanta nga Federata.
3. Kryetari i nderit dhe Anëtarët e nderit zgjidhen pa kufizim kohor.
4. Nuk është i mundur emërimi i më shumë se një Kryetari të nderit në të njëjtën kohë.
5. Kryetari i nderit ka të drejtë pjesëmarrjeje pa të drejtë vote në mbledhjet e Kuvendit të Bordit të Federatës.

XX. PASURIA E FEDERATËS

Neni 20

1. Pasurinë e Federatës e përbën pasuria e paluajtshme dhe e luajtshme, të drejtat material, mjetet financiare, letrat me vlerë dhe pasuria tjetër që ka dhe me të cilën qeverisë Federata.
 2. Me pasurinë e Federatës qeverisin anëtarët e Kuvendit, Bordi, Kryetari i Federatës.
 3. Pasuria e Federatës përfshin: fondet e ndara nga Departamenti i Sportit përmes projekteve të ndryshme; fondet e donatorëve; të hyrat nga aksionet, manifestimet e ndryshme, nga veprimtaria vetjake, të drejtat autoriale, kontributet, donacionet, ndërsa kompensimi i dëmit që personat juridikë dhe fizikë i shkaktajnë Federatës, si dhe të hyrat tjera do të përcaktohen në bazë të ligjeve në fuqi.
-

XXI. SHPËRBËRJA E FEDERATËS

Neni 21

1. Shpërbërja e Federatës mund të bëhet me vendim të shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Federatës.
2. Kur të merret vendimi për shpërbërjen e Federatës, anëtarët e Federatës do të tregojnë emrin e organizatës apo organizatën që do të marrin pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet dhe obligimet e Federatës. Shoqatat dhe fondacionet duhet të kenë qëllime të njëjta apo të ngjashme sikurse Federata.

XXII. NDRYSHIMET E STATUTIT

Neni 22

1. Statuti i tashëm mund të ndryshohet me vendim të 2/3 të anëtarëve të pranishëm në Kuvendin e Federatës.

XXIII. AFARIZMI MATERIAL DHE FINANCIAR

Periudha e raportimit dhe Viti Financiar

Neni 23

1. Bordi i Federatës dhe zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit, MPV apo kurdoherë që ajo kërkohet nga një MPJ.
2. Viti kalendarik i Federatës duhet të përputhet me vitin kalendarik.

XXIV. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 24

1. Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar me këtë statut do të rregullohen me akte të tjera normative, të cilat mund t'i nxjerr Kuvendi në MPV dhe MPJ.
-

Neni 25

1. Me përfundim të mandatit të Bordit Ekzekutiv dhe zgjedhjes të Bordit të ri Ekzekutiv, duhet të bëhet pranim dorëzimi i detyrës nga kryetari paraprak dhe ai i zgjedhur me një procesverbal të nënshkruar nga të dy kryetarët në zyrën e FKK-së.
2. Procesverbali duhet të përmbajë të gjitha asetet aktuale të FKK-së me të cilat FKK ka zhvilluar aktivitetet e veta, dokumentacionin zyrtar të FKK-së, arkivën, dosjet dhe fjalëkalimet e emailave zyrtarë dhe web faqes së FKK-së, fjalëkalimin e llogarisë së FKK-së në sport data dhe autorizimin për llogaritë bankare të FKK-së.

Ky statut është aprovuar në Prishtinë.

Data: 19 qershor 2021

Kryetar i Federatës

Ismet Krasniqi

